PËRGJIGJE TË QARTA QË JEP

ISLAMI

NË PYETJE TË RËNDËSISHME



UMER BIN ABDURRAHMAN EL-UMER

Përgjigje të qarta
që jep Islami
në pyetje
të rëndësishme

Autor: Umer bin AbduRrahman el-Umer

Përktheu: Servet Mata

Feja Islame – Përgjigje të qarta që jep Islami në pyetje të rëndësishme

Titulli në origjinal: الأجوبة الشافية على أسئلة مهمة فى ضوء الإسلام

Autor: Umer bin AbduRrahman el-Umer

Përktheu: Servet Mata

Redaktoi: Jeton Shasivari

Botim i parë

© E drejta e autorit 2026 nga selefi-al.com

Botuesi posedon çdo të drejtë. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të kopjohet e të shpërndahet në asnjë mënyrë, apo të ruhet në ndonjë sistem regjistrimi apo memorizimi të asnjë lloji, pa marrë paraprakisht lejen e botuesit.

Tiranë, 2026

Islamic Center in Thumamah
Registered in the Ministry of Human Resources and Social Development No.(3529)

جمعية الدعوة والارشاد وتوعية الجاليات بالثمامة
Islamic Center in Thumamah

جمعية الدعوة والارشاد وتوعية الجاليات بالثمامة
مسجلة في وزارة الموارد البشرية والتنمية الاجتماعية برقم (٣٥٢٩)

الحمدلله رب العالمين والصلاة والسلام على نبينا محمد وعلى آله وصحبه اجمعين ،،،

فقد أذنت للأخ الفاضل ثروت ماتى من ألبانيا وخريج الجامعة الإسلامية في المدينة النبوية جزاه الله خيرا بترجمة كتابي إرشاد الأنام إلى أصول ومهمات دين الإسلام وكذلك كتابي الثاني الأجوبة الشافية على أسئلة مهمة في ضوء الإسلام.

وأسأل الله تعالى أن ينفع بهذين الكتابين عموم المسلمين وغير المسلمين والله الهادي إلى سواء السبيل ،،

رئيس مجلس الإدارة

جمعية الدعوة والارشاد وتوعية الجاليات بالثمامة
Islamic Center in Thumamah
رقم التسجيل ٣٥٢٩

د.عمر بن عبدالرحمن العمر

Lavdia dhe falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve. Mëshira dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi Profetin tonë Muhammedin, mbi familjen e tij dhe mbi të gjithë shokët e tij.

I kam dhënë leje vëllait të nderuar, Servet Mata nga Shqipëria, të diplomuar në Universitetin Islamik në Medinen Profetike – Allahu e shpërbleftë me të mira – për përkthimin e librit tim "Udhërrëfyes për njerëzit mbi bazat dhe çështjet kryesore të fesë Islame", si dhe të librit tim të dytë "Përgjigje të qarta që jep Islami në pyetje të rëndësishme".

E lus Allahun e Lartësuar që nëpërmjet këtyre dy librave t'u sjellë dobi të gjithë muslimanëve dhe jomuslimanëve. Allahu është Ai që udhëzon drejt rrugës së drejtë.

Shkroi: Umer ibn AbduRrahman el-Umer

Parathënia e autorit!

Lavdia dhe falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Mëshira dhe shpëtimi qofshin për Profetin tonë Muhammedin, si dhe për të gjithë Profetët dhe të Dërguarit.

Më tej:

Disa njerëz e kanë kuptuar fenë Islame në mënyrë të gabuar dhe kanë filluar t'i atribuojnë asaj gjëra që nuk janë të vërteta, duke e akuzuar për çështje prej të cilave ajo është e pastër dhe nuk ka lidhje me to.

Për këtë arsye, o lexues i nderuar, është përgatitur ky libër që ke në duar, me synimin që të arrihet tek e vërteta dhe që të paraqitet pamja e saktë e Islamit, të cilën organizatat terroriste dhe mediat e korruptuara janë përpjekur ta shtrembërojnë dhe deformojnë.

Në këtë libër do të gjesh përgjigje të qarta dhe të mjaftueshme për një sërë çështjesh dhe temash të rëndësishme, në dritën e Islamit të vërtetë, të drejtpeshuar dhe të moderuar, me të cilin erdhi i Dërguari i Allahut, Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe sipas të cilit ecën shokët e tij fisnikë.

Qëllimi im me shkrimin e këtij libri është të arrihet drejtësia në gjykimin ndaj Islamit, si dhe të sqarohet realiteti dhe bukuritë e tij, me qëllim që njerëzit të nxiten të hyjnë në të.

Librin e kam përpiluar në formë pyetjesh dhe përgjigjesh, në mënyrë që informacionet të jenë më të lehta për t'u kuptuar dhe më të afërta për t'u përvetësuar.

Suksesi vjen vetëm prej Allahut. Mëshira dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi Profetin tonë Muhammedin!

Përmbajtja e pyetjeve të librit!

1. Kush na ka krijuar? 9
2. Përse na krijoi Allahu në jetën e kësaj bote? 10
3. Cila është rruga e saktë për ta adhuruar Allahun e Lartësuar? 12
4. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj Isait (Jezusit), *alejhis-selam*? 14
5. A është Isai (Jezusi), *alejhis-selam*, Zoti dhe i Adhuruari me të drejtë? 15
6. A është Isai (Jezusi), *alejhis-selam*, biri i Allahut? 17
7. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj Merjemes, *alejhas-selam?* 20
8. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj të gjithë të Dërguarve dhe Profetëve? 21
9. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj besimit në Ditën e Gjykimit? 22
10. Cilat janë pesë domosdoshmëritë që Islami ka ardhur t'i ruajë dhe t'i mbrojë? 23
11. Si është Islami shkak për lumturinë e njerëzve? 25
12. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj pastërtisë personale dhe shëndetit publik? 27
13. Cilat janë adhurimet më të rëndësishme në Islam dhe cilat janë dobitë e tyre? 28
14. Cilat janë veçoritë e sistemit ekonomik në Islam? 30
15. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj gruas? 31
16. A i ka bërë padrejtësi Islami gruas duke i bërë detyrim hixhabin (mbulesën)? 33

17. A është Islami fe e terrorizmit? 34
18. A janë muslimanët terroristë? 36
19. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj dhunës? 37
20. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj diskriminimit racor? 40
21. Si mund ta përqafoj fenë Islame? 41

1. **Kush na ka krijuar?**

Përgjigje:

Allahu i Lartësuar është Ai që na krijoi dhe na solli në ekzistencë. Ai është i Cili krijoi qiejt, tokën, malet, pemët, detet, lumenjtë, diellin, hënën dhe të gjitha krijesat.

Allahu i Lartësuar thotë në Kur'anin Fisnik:

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَأَنزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَّكُمْ ۖ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْفُلْكَ لِتَجْرِيَ فِي الْبَحْرِ بِأَمْرِهِ ۖ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْأَنْهَارَ وَسَخَّرَ لَكُمُ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ دَائِبَيْنِ ۖ وَسَخَّرَ لَكُمُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ

"Allahu është Ai që krijoi qiejt dhe tokën, zbriti ujë nga qielli dhe nëpërmjet tij nxori fruta si furnizim për ju. Ai nënshtroi për ju anijet që të lundrojnë në det me urdhrin e Tij; Ai nënshtroi për ju lumenjtë; dhe Ai nënshtroi për ju diellin dhe hënën, që lëvizin vazhdimisht. Ai nënshtroi për ju natën dhe ditën." [Ibrahim, 32-33]

Dhe Allahu i Lartësuar thotë:

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنسَانَ مِن سُلَالَةٍ مِّن طِينٍ ثُمَّ جَعَلْنَاهُ نُطْفَةً فِي قَرَارٍ مَّكِينٍ ثُمَّ خَلَقْنَا النُّطْفَةَ عَلَقَةً فَخَلَقْنَا الْعَلَقَةَ مُضْغَةً فَخَلَقْنَا الْمُضْغَةَ عِظَامًا فَكَسَوْنَا الْعِظَامَ لَحْمًا ثُمَّ أَنشَأْنَاهُ خَلْقًا آخَرَ ۚ فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ ثُمَّ إِنَّكُم بَعْدَ ذَٰلِكَ لَمَيِّتُونَ ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ تُبْعَثُونَ

"Me të vërtetë, Ne e krijuam njeriun prej një cope balte. Pastaj e bëmë atë pikë uji (farë) në një vend të sigurt (mitër). Më pas, pikën e ujit e bëmë mpiksje gjaku, pastaj mpiksjen

e gjakut e bëmë copë mishi, pastaj copën e mishit e bëmë eshtra, dhe eshtrat i veshëm me mish. Pastaj e nxorëm jashtë si një krijesë e re. I Madhëruar është Allahu, Krijuesi i përsosur. Pastaj, pas gjithë kësaj, ju padyshim do të vdisni. Pastaj, në Ditën e Kijametit, ju do të ringjalleni." [El-Mu'minun, 12-16]

2. Përse na krijoi Allahu në jetën e kësaj bote?

Përgjigje:

Allahu i Lartësuar na krijoi në jetën e kësaj bote që ta adhurojmë Atë, t'i bindemi Atij dhe t'i zbatojmë veprimet që Ai na urdhëron dhe t'i braktisim ato që Ai na i ndalon.

Allahu i Madhëruar thotë:

لِيَعْبُدُونِ إِلَّا وَالْإِنسَ الْجِنَّ ۚ خَلَقْتُ وَمَا

"Unë nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit për gjë tjetër, përveçse që të Më adhurojnë vetëm Mua." [Edh-Dharijat, 56]

Adhurimi në Islam nuk është i kufizuar vetëm në xhami, ku Muslimanët falin namazin. Përkundrazi, kuptimi i adhurimit përfshin:

- përpikërinë ndaj Krijuesit, përmes namazit dhe adhurimeve të tjera;
- mirësinë ndaj krijesave, përmes ndihmës, sjelljes së mirë dhe moralit të bukur.

Prandaj disa dijetarë Muslimanë e kanë përkufizuar adhurimin kështu:

"Adhurimi është fjalë gjithëpërfshirëse, që përfshin çdo gjë që Allahu e do dhe është i kënaqur me të, duke përfshirë çdo fjalë dhe vepër të dukshme e të fshehtë."

Adhurimi vetëm i Allahut, pa i shoqëruar Atij askënd e asgjë në adhurim, është njohje dhe pranim i të drejtës së Allahut dhe falënderim ndaj Tij për mirësitë e Tij të mëdha.

Ai është i Cili na krijoi në barqet e nënave tona, na dha dëgjimin, shikimin, gjymtyrët dhe mendjen me të cilën mund të mendojmë dhe të mësojmë. Ai na furnizoi me lloje të shumta ushqimesh, pijesh dhe mirësish të tjera të panumërta.

Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që ta falënderojmë Atë dhe të mos i mohojmë mirësitë e Tij.

Ai thotë:

تَكْفُرُونِ وَلَا لِي وَاشْكُرُوا أَذْكُرْكُمْ فَاذْكُرُونِي

"Më përkujtoni Mua (me adhurime), që Unë t'ju përmend juve (me mëshirë e falje); më falënderoni Mua dhe mos i mohoni mirësitë e Mia." [El-Bekareh, 152]

3. Cila është rruga e saktë për ta adhuruar Allahun e Lartësuar?

Përgjigje:

Rruga e saktë për ta adhuruar Allahun e Lartësuar është përqafimi i fesë Islame dhe besimi në të Dërguarin e Islamit, Muhammedin, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*[1].

Muhammedi është përmendur në Teurat (Tora) në librin "Ligji i Përtërirë (Deuteronomi), kapitulli 18".

Gjithashtu, Isai (Jezusi), *alejhis-selam*, i ka lajmëruar pasuesit e tij se do të vinte pas tij një i Dërguar me emrin Muhammed dhe i ka nxitur njerëzit që ta pasojnë atë. Përmendja e Muhamedit gjendet edhe në Ungjillin sipas Gjonit, kapitulli 16.

Thirrja e Profetit Muhammed, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, është për të gjithë njerëzit e botës, arabë dhe joarabë, dhe mesazhi i tij është mëshirë për të gjitha botët, siç thotë Allahu i Lartësuar:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِلْعَالَمِينَ

"Ne të kemi dërguar ty si mëshirë për botët." [El-Enbija, 107]

[1] Mëshira dhe shpëtimi i Allahut qofshin me të.

Po ashtu, Teurati dhe Ungjilli, si libra të shenjtë të shpallur më parë, udhëzojnë drejt besimit në Muhamedin, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe në fenë Islame që ai solli.

Ja disa shembuj:

Kur një i Krishterë, që quhej Melvin LeBlanc (AbdulMalik Le Blanc), përqafoi Islamin, shkroi një libër me titull: "Ungjilli është ai që më udhëhoqi drejt Islamit."

Gjithashtu, kur një i Krishterë tjetër, me emrin Simon Alfredo, përqafoi Islamin, shkroi një libër me titull: "Dashuria ime e madhe për Mesihun Isain, alejhis-selam, më udhëhoqi drejt Islamit."

Kushdo që lexon për Islamin dhe e njeh realitetin dhe veçoritë e tij, pa u ndikuar nga mediat mashtruese, do ta kuptojë se ai është feja e vërtetë, feja e mëshirës, feja e drejtësisë dhe feja e paqes.

Islami është i pastër nga veprimet e terroristëve të cilët veprat e tyre ia atribuojnë atij.

Kur një njeri e përqafon Islamin, ai do të ndiejë qetësi shpirtërore, zgjerim të kraharorit, rehati të zemrës dhe lumturi në këtë botë dhe në Botën tjetër.

4. **Cili është qëndrimi i Islamit ndaj Isait (Jezusit), *alejhis-selam*?**

Përgjigje:

Muslimanët e duan shumë Jezusin, *alejhis-selam*, dhe besojnë se ai është një i Dërguar fisnik i Allahut dhe një njeri madhështor.

Tregues i kësaj është fakti se emri i tij përmendet njëzet e pesë herë në Kur'an, Librin e shenjtë të Muslimanëve.

Gjithashtu, në Kur'an gjendet një *Sure* (kaptinë) e tërë që mban emrin e njërës prej mrekullive të Jezusit, *alejhis-selam*, e cila është Sureja *el-Maideh* (Sofra e shtruar).

Prej gjërave të çuditshme që është për t'u vënë re, është se kjo mrekulli nuk përmendet në asnjërin prej katër Ungjillëve.

Po ashtu, Muslimanët nuk pranojnë që emri i Jezusit të përmendet pa u shoqëruar me shprehjen *"alejhis-selam" [shpëtimi i Allahut qoftë për të]*, dhe e konsiderojnë mungesën e kësaj shprehjeje si mungesë respekti ndaj këtij Profeti fisnik.

5. A është Isai (Jezusi), *alejhis-selam*, Zoti dhe i Adhuruari me të drejtë?

Përgjigje:

Besimi se dikush tjetër është i barabartë me Allahun është *shirk* (idhujtari, politeizëm). Shirku është mëkati më i madh, sepse cenon të drejtën që ka Allahu për t'u adhuruar dhe për t'iu nënshtruar, gjë që nuk i takon askujt tjetër përveç Tij.

Prandaj, nuk lejohet të marrim të adhuruar të tjerë bashkë me Allahun e Lartësuar, as Jezusin e as ndonjë krijesë tjetër.

Vetë Jezusi, *alejhis-selam*, me fjalët dhe veprat e tij, tregoi se ishte Profet i dërguar dhe se vetëm Allahu është i Adhuruari i tij dhe i Adhuruari i të gjitha botëve. Kur ai ishte në tokë, i lutej vetëm Allahut, duke thënë:

"Ti je i vetmi i Adhuruar i vërtetë." [Gjoni 17:3]

Gjithashtu, në Kur'an është shpallur se vetë Jezusi, *alejhis-selam*, e pranoi se nuk është i adhuruar me të drejtë, por vetëm Allahu është i Adhuruari i tij dhe i Adhuruari i të gjitha krijesave.

Allahu i Lartësuar thotë:

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ ۖ وَقَالَ الْمَسِيحُ يَا بَنِي إِسْرَائِيلَ اعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ ۖ إِنَّهُ مَن يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ النَّارُ ۖ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنصَارٍ

"Pa dyshim se kanë bërë kufër (mosbesim) ata që thanë: 'Allahu është Mesihu, biri i Merjemes.' Ndërsa vetë Mesihu tha: 'O bijtë e Israilit! Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj. Kush i shoqëron Allahut dikë në adhurim, Allahu ia ka bërë të ndaluar Xhennetin dhe vendbanimi i tij do të jetë Zjarri. Për zullumqarët nuk do të ketë ndihmues." [El-Maideh, 72]

Gjithashtu, thuhet se Jezusi, *alejhis-selam,* është krijesë, që lindi nga barku i nënës së tij, Merjemes, *alejhas-selam*.

Mirëpo krijesa nuk mund të jetë një i adhuruar me të drejtë, sepse i Adhuruari me të drejtë është Zoti, Krijuesi, e Ai është Allahu i Lartësuar.

Allahu i Lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَّكُمْ ۖ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَندَادًا وَأَنتُمْ تَعْلَمُونَ

"O njerëz! Adhuroni vetëm Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush, që të bëheni të devotshëm. Adhuroni Atë, që e bëri tokën shtrat për ju, qiellin ndërtesë, zbriti ujë nga qielli dhe nëpërmjet tij nxori fruta si furnizim për ju. Prandaj, mos i bëni Allahut ortakë në adhurim, ndërkohë që e dini." [El-Bekareh, 21-22]

Pra, Ai që krijoi njerëzit, tokën dhe qiejt, Ai që zbret shiun nga qielli dhe nxjerr bimët nga toka, është i Vetmi që meriton të adhurohet, e Ai është Allahu i Lartësuar.

6. A është Isai (Jezusi), *alejhis-selam,* biri i Allahut?

Përgjigje:

Isai, *alejhis-selam,* nuk është biri i Allahut, sepse një nga Emrat e Allahut është *el-Ganij* [i Vetëmjaftueshmi]. Ai ka vetëmjaftueshmëri të plotë në çdo aspekt; nuk ka nevojë për askënd dhe për asgjë.

Përderisa Ai është i Vetëmjaftueshëm, atëherë çfarë nevoje do të kishte për fëmijë?! Nevoja për fëmijë bie ndesh me përsosmërinë e Vetëmjaftueshmërisë, sepse njerëzit zakonisht kërkojnë pasardhës për shkak të një nevoje ose mangësie.

Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an:

قَالُوا اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا ۗ سُبْحَانَهُ ۖ هُوَ الْغَنِيُّ ۖ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۚ إِنْ عِندَكُم مِّن سُلْطَانٍ بِهَٰذَا ۚ أَتَقُولُونَ عَلَى اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ

"Ata thanë: 'Allahu është bërë me fëmijë.' I pastër prej të metave është Ai! Ai është i Vetëmjaftueshmi. Atij i përket gjithçka që është në qiej dhe në tokë. Ju nuk keni asnjë argument për këtë. Si mund ta thoni për Allahun atë që nuk e dini?!" [Junus, 68]

Një argument tjetër që e hedh poshtë pretendimin se Jezusi është biri i Allahut është se fëmija zakonisht i ngjan prindit të tij në cilësi dhe veprime, ndërsa Allahut nuk i ngjan asnjë prej krijesave të Tij.

Allahu thotë:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ۖ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ

"Asgjë nuk i përngjan Atij, dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi." [Esh-Shuura, 11]

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ • اللَّهُ الصَّمَدُ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ وَلَمْ يَكُن لَّهُ كُفُوًا أَحَدٌ

"Thuaj (o Muhamed)! Ai është Allahu, Ai është Një dhe i Vetëm! Allahu është Es-Samed (Atij i drejtohen krijesat për nevojat e tyre, Ai është i Vetëmjaftueshëm)! Ai as ka lindur kënd, dhe as është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë dhe i krahasueshëm me Të." [El-Ikhlas, 1-4]

Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَٰنُ وَلَدًا لَّقَدْ جِئْتُمْ شَيْئًا إِدًّا تَكَادُ السَّمَاوَاتُ يَتَفَطَّرْنَ مِنْهُ وَتَنشَقُّ الْأَرْضُ وَتَخِرُّ الْجِبَالُ هَدًّا أَن دَعَوْا لِلرَّحْمَٰنِ وَلَدًا وَمَا يَنبَغِي لِلرَّحْمَٰنِ أَن يَتَّخِذَ وَلَدًا

"Ata thanë: 'I Gjithëmëshirshmi është bërë me fëmijë.' Me të vërtetë, ju keni sjellë një shpifje të tmerrshme. Prej kësaj shpifjeje gati sa nuk copëtohen qiejt, nuk çahet toka dhe nuk shemben malet! Ngaqë ata të Gjithëmëshirshmit i atribuojnë fëmijë. Kurrë nuk i takon të Gjithëmëshirshmit të ketë fëmijë." [Merjem, 88-92]

Sa i përket pretendimit të disa njerëzve se Jezusi, *alejhis-selam,* është biri i Allahut sepse nuk ka pasur baba, ai është një pretendim i pavërtetë.

Ademi, *alejhis-selam,* babai i njerëzimit, nuk ka pasur as baba e as nënë, megjithatë askush nuk thotë se ai është biri i Allahut të Lartësuar.

Allahu i Lartësuar, i Cili pati fuqi ta krijojë Ademin pa baba dhe pa nënë, ka fuqi ta krijojë Jezusin vetëm nga një nënë, pa baba. Nëse mungesa e babait do të ishte argument për të pretenduar se Jezusi është bir i Allahut, atëherë ky pretendim do të ishte më i fortë për Ademin, gjë që është e pavërtetë. Prandaj, pretendimi se Jezusi, *alejhis-selam,* është bir i Allahut, është edhe më i pabazë e më i kotë.

Allahu e ka përmendur në Kur'anin Fisnik se Jezusi është si Ademi:

فَيَكُونُ كُن لَهُ قَالَ ثُمَّ تُرَابٍ مِن خَلَقَهُ ۖ آدَمَ كَمَثَلِ اللَّهِ عِندَ عِيسَىٰ مَثَلَ إِنَّ

"Shembulli i Isait (Jezusit) tek Allahu është si shembulli i Ademit: Ai e krijoi atë prej dheut, pastaj i tha: 'Bëhu!' dhe ai u bë." [Al 'Imran, 59]

Nëse dikush pyet: Përse Allahu e krijoi Jezusin pa baba?

Përgjigjja është: Që Allahu t'u tregojë krijesave fuqinë e Tij të pakufishme, se Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë dhe bën çfarë të dëshirojë.

Ashtu siç e krijoi Ademin pa baba dhe pa nënë, po ashtu krijoi Jezusin nga një nënë pa baba.

Merjemja, *alejhas-selam,* tha:

قَضَىٰ إِذَا ۚ يَشَاءُ مَا يَخْلُقُ اللَّهُ كَذَٰلِكِ قَالَ ۖ بَشَرٌ يَمْسَسْنِي وَلَمْ وَلَدٌ لِي يَكُونُ أَنَّىٰ رَبِّ قَالَتْ
فَيَكُونُ كُن لَهُ يَقُولُ فَإِنَّمَا أَمْرًا

"Ajo tha: 'Zoti im, si mund të kem fëmijë kur asnjë njeri nuk më ka prekur?!' Ai (Xhibrili) tha: 'Kështu është; Allahu krijon çfarë të dojë. Kur vendos për një çështje, Ai vetëm i thotë: "Bëhu!" dhe ajo bëhet." [Al 'Imran, 47]

7. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj Merjemes, *alejhas-selam?*

Përgjigje:

Qëndrimi i Islamit ndaj Merjemes, *alejhas-selam,* është se ajo është njëra ndër gratë më të mira në botë.

Ajo është e vetmja grua për të cilën ka Sure të tërë në Kur'an me emrin e saj, Sureja *Merjem*.

Gjithashtu, emri i saj përmendet drejtpërsëdrejti tridhjetë e katër herë në Kur'an, ndërsa në të gjithë librin e të Krishterëve përmendet vetëm tetëmbëdhjetë herë.

Po ashtu, Sureja e tretë e Kur'anit, Sureja *Al' Imran*, mban emrin e familjes së saj. Në këtë Sure, Allahu i Lartësuar tregon se Merjemeja është njëra ndër gratë më të mira në botë. Allahu thotë:

وَإِذْ قَالَتِ الْمَلَائِكَةُ يَا مَرْيَمُ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَاكِ وَطَهَّرَكِ وَاصْطَفَاكِ عَلَىٰ نِسَاءِ الْعَالَمِينَ

"Dhe përkujto kur engjëjt thanë: O Merjem! Allahu të dalloi ty, të pastroi (nga politeizmi dhe nga shpifjet ndaj teje), si dhe të ngriti mbi gratë e botës." [Al 'Imran, 42]

Për këtë arsye, shumë Muslimanë ua vendosin vajzave të tyre emrin Merjem, si shenjë nderimi dhe dashurie për të.

Gjithashtu, gratë Muslimane janë ndër gratë që më së shumti mbajnë hixhab, njëjtë siç mbante edhe Merjemeja, *alejhas-selam*.

8. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj të gjithë të Dërguarve dhe Profetëve?

Përgjigje:

Islami thërret në besimin në të gjithë Profetët dhe të Dërguarit të cilët Allahu i Lartësuar i ka dërguar për të udhëzuar njerëzit, për t'i nxjerrë ata nga errësirat e mosbesimit në dritën e besimit, dhe për t'i kaluar nga jeta e mjerimit [përfundimit në Zjarr], në jetën e lumturisë [përfundimit në Xhennet].

Islami nuk bën dallim midis të Dërguarve, përkundrazi urdhëron të besohet në të gjithë ata, si Nuhu, Ibrahimi, Musai, Isai dhe Muhammedi, mëshira dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të gjithë ata; sepse ata janë të Dërguarit e Allahut tek njerëzit.

Mohimi qoftë edhe i vetëm njërit prej tyre është mohim i të gjithë të Dërguarve, madje është mohim ndaj Allahut të Lartësuar.

Islami, gjithashtu, thërret në dashuri për të gjithë Profetët dhe në pasimin e tyre, sepse bindja ndaj tyre është bindje ndaj Allahut të Lartësuar.

Megjithatë, nuk i lejohet askujt ta marrë ndonjërin prej tyre si të adhuruar dhe t'i dedikojë atij adhurime. Përkundrazi, i Dërguari është rob i Allahut dhe nuk adhurohet, por është i Dërguar dhe nuk përgënjeshtrohet.

9. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj besimit në Ditën e Gjykimit?

Përgjigje:

Islami thërret në besimin në Ditën e Gjykimit, që do të thotë: besim i palëkundur se Allahu i Lartësuar ka fuqi t'i ringjallë njerëzit pas vdekjes, t'i nxjerrë nga varret e tyre dhe t'i marrë në llogari e t'i shpërblejë sipas veprave që kanë bërë në këtë botë.

Ai që ka besuar në Allahun dhe i është bindur Atij, do të hyjë në Xhennet.

Ndërsa ai që nuk ka besuar në Allahun dhe i ka kundërshtuar urdhëresat e Tij, do të hyjë në Zjarr (Xhehennem).

10. Cilat janë pesë domosdoshmëritë që Islami ka ardhur t'i ruajë dhe t'i mbrojë?

Përgjigje:

Pesë domosdoshmëritë themelore që Islami ka ardhur t'i ruajë janë:

1. **Ruajtja e fesë.**

Qëllimi është ruajtja e besimit në Allahun, forcimi i lidhjes me Të dhe ruajtja e adhurimit, duke e bërë vetëm për Atë, pa i shoqëruar të tjerë në adhurim. Ky është shkaku i lumturisë së njeriut në këtë botë dhe në Botën tjetër.

2. **Ruajtja e jetës.**

Me këtë nënkuptohet respektimi i jetës së çdo njeriu të mbrojtur, qoftë Musliman apo jomusliman, si dhe ndëshkimi i atij që cenon jetën e tjetrit pa të drejtë.

Për këtë arsye, Islami ka sqaruar rrezikun e krimit të vrasjes dhe të terrorizmit, dhe ashpërsinë e dënimit për vrasësin.

3. **Ruajtja e mendjes.**

Me këtë nënkuptohet se Islami ka theksuar rëndësinë e ruajtjes dhe respektimit të mendjes, me anë të së cilës njeriu është dalluar nga kafshët.

Për këtë arsye, Islami ka ndaluar lëndët narkotike, alkoolin dhe çdo substancë dehëse, me qëllim që të mbrohet njeriu dhe

të mos bëjë veprime të gabuara apo të cenojë ose dëmtojë të tjerët si pasojë e humbjes së arsyes.

4. Ruajtja e nderit.

Kjo nënkupton se Islami ka ardhur për ta mbrojtur shoqërinë nga krimet e përdhunimit dhe marrëdhëniet seksuale të ndaluara, të cilat shkaktojnë përhapjen e sëmundjeve të rënda dhe shtimin e fëmijëve të lindur jashtë martese.

Prandaj, Islami ka nxitur martesën dhe ndërtimin e familjes mbi baza të shëndosha, ndërsa ka ndaluar *zina*-në (marrëdhëniet jashtëmartesore) dhe çdo marrëdhënie të ndaluar.

5. Ruajtja e pasurisë.

Me këtë nënkuptohet se Islami ka ardhur për të mbrojtur pasurinë, sepse ajo është një nga shtyllat e jetës.

Ai ka lejuar mënyrat e ligjshme të fitimit të saj dhe ka ndaluar mënyrat e paligjshme, si vjedhja, kamata *(ribaja)*, mashtrimi dhe përvetësimi i pasurisë së njerëzve pa të drejtë.

11. Si është Islami shkak për lumturinë e njerëzve?

Përgjigje:

Islami ka ardhur për t'u sjellë lumturi njerëzve dhe që jeta e tyre të jetë e mirë. Kjo bëhet e qartë nëpërmjet pikave të mëposhtme:

1. Islami synon përmirësimin e fesë dhe përmirësimin e jetës së kësaj bote. Ai vendos një ekuilibër ndërmjet punës për këtë botë dhe punës për Botën tjetër. Dispozitat e tij janë të përshtatshme për çdo kohë dhe çdo vend.
2. Islami merr parasysh kërkesat dhe nevojat e shpirtit dhe të trupit, sepse njeriu përbëhet nga shpirti dhe trupi, dhe ka nevoja shpirtërore e materiale.
3. Islami kujdeset për dobitë dhe interesat e njerëzve. Islami nuk ka lënë asnjë dobi njerëzore pa nxitur drejt saj, si dhe nuk ka lënë asnjë dëm pa e ndaluar dhe pa urdhëruar shmangien e tij.
4. Islami bazohet në besimin e drejtë e të dobishëm, në morale të larta e fisnike që edukojnë shpirtin dhe mendjen, në vepra që përmirësojnë gjendjen e njerëzve, dhe në argumente të qarta për bazat dhe degët e tij.
5. Në dispozitat e Islamit nuk ka asgjë që bie ndesh me arsyen e shëndoshë. Përkundrazi, arsyeja e drejtë dëshmon për vërtetësinë, dobinë dhe përsosmërinë e këtyre dispozitave.
6. Burimi më i madh i legjislacionit islam është Kur'ani Fisnik. Të gjitha urdhëresat dhe ndalesat e tij janë të drejta dhe nuk përmbajnë padrejtësi, sepse Kur'ani është

shpallur nga Allahu i Lartësuar dhe nuk është shtrembëruar apo ndryshuar nga njerëzit, siç ka ndodhur me Ungjillin.

Vetë Allahu i Lartësuar e ka marrë përsipër ruajtjen e Kur'anit. Thotë i Lartësuari:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ

"Pa dyshim, Ne e kemi zbritur Shpalljen (Kur'anin) dhe Ne do ta ruajmë atë." [El-Hixhr, 9]

7. Islami thërret në çdo gjë që u sjell njerëzve lumturi dhe sukses, dhe ndalon çdo gjë që u sjell atyre mjerim dhe dëm.
8. Islami urdhëron drejtësi, besnikëri dhe përmbushje të marrëveshjeve, ndërsa ndalon padrejtësinë, tradhtinë dhe mashtrimin. Ai është i pastër nga veprat terroriste që kryejnë disa njerëz të cilët i atribuohen Islamit.
9. Islami është fe e bashkëjetesës dhe e paqes. Përshëndetja më e njohur e Muslimanëve që e përsërisin vazhdimisht është: "es-selamu alejkum" [Paqja e Allahut qoftë mbi ju!].
10. Islami thërret në ruajtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtave të prindërve, fëmijëve, të afërmve, fqinjëve, grave, fëmijëve dhe punëtorëve. Ai thërret në ruajtjen e të drejtave që bashkëshortët kanë ndaj njëri-tjetrit. Madje ka urdhëruar edhe ruajtjen e të drejtave të kafshëve.
11. Islami nxit sjelljen e mirë dhe ndihmën ndaj të moshuarve, fëmijëve, jetimëve, personave me aftësi të kufizuara, të varfërve dhe nevojtarëve.

12. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj pastërtisë personale dhe shëndetit publik?

Përgjigje:

Islami thërret si në pastërtinë e brendshme shpirtërore, ashtu edhe në pastërtinë e jashtme, e që është shëndeti publik.

Pastërtia e brendshme arrihet duke u larguar nga besimet e gabuara, qëllimet e këqija, idetë e devijuara, urrejtja dhe zilia.

Pastërtia e jashtme ka të bëjë me higjienën personale dhe kujdesin për trupin dhe shëndetin. Për këtë arsye, Islami urdhëron pastrimin me ujë të vendit të papastërtisë pas urinimit ose jashtëqitjes.

Gjithashtu, Islami urdhëron larjen e të gjithë trupit *(gusli)* pas xhunubllëkut (marrëdhënieve intime), si për burrin ashtu edhe për gruan. Po ashtu, gruaja e ka detyrë të lajë të gjithë trupin pasi të përfundojnë menstruacionet ose gjakderdhja e lehonisë.

Islami, gjithashtu, e nxit burrin që të lajë të gjithë trupin çdo javë, ditën e xhuma, para se të shkojë në namazin e xhumasë, i cili është një nga namazet më të rëndësishme.

Po ashtu, Islami nxit:

- heqjen e qimeve të sqetullave,
- rruajtjen e qimeve në vendet intime,
- prerjen e thonjve,
- përdorimin e parfumit,

- larjen e vazhdueshme të dhëmbëve, qoftë me furçë dhe pastë dhëmbësh, apo me *misvak*, i cili është i njohur te Muslimanët.

Gjithashtu, Islami urdhëron mbajtjen e pastër të rrobave të brendshme dhe të jashtme, si dhe mbrojtjen e tyre nga papastërtitë, si urina ose jashtëqitja.

13. Cilat janë adhurimet më të rëndësishme në Islam dhe cilat janë dobitë e tyre?

Përgjigje:

Adhurimet më të rëndësishme në Islam janë: namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi.

Namazi është detyrimi më i madh në Islam. Ai falet pesë herë në ditë, në kohë të ndryshme.

Namazi forcon lidhjen e njeriut me Allahun e Lartësuar, fshin mëkatet, i hap kraharorin njeriut dhe i sjell qetësi shpirtit, largon shqetësimin dhe ankthin, si dhe e mbron njeriun nga fjalët, veprat dhe sjelljet e këqija. Namazi është ndihma më e madhe për robin në çështjet e fesë dhe të jetës së tij.

Zekati është një nga detyrimet e rëndësishme të Islamit. Zekati është: obligimi që një pjesë e pasurisë të ndahet për të varfrit që e meritojnë, një herë në vit, nga ana e atij që e ka detyrim.

Një nga dobitë e zekatit janë: realizimi i parimit të solidaritetit shoqëror, forcimi i bashkëpunimit dhe dashurisë ndërmjet të pasurve dhe të varfërve, si dhe largimi i njeriut nga koprracia dhe lakmia.

Agjërimi i një muaji në vit është, gjithashtu, një nga detyrimet e Islamit, që është muaji i Ramazanit.

Nga dobitë e agjërimit janë: Edukimi i shpirtit, vetes dhe trupit. Stërvitja e njeriut për durim dhe butësi. Përkujtimi nevojave të të varfërve për ushqim dhe pije, me qëllim që të solidarizohemi me ata dhe t'i ngushëllojmë ata.

Disa nga dobitë e agjërimit janë: Ruajtja e shëndetit trupor dhe gjallërisë dhe aktivitetit të tij. Dobi tjetër është gjithashtu pastrimi i trupit nga helmet, si dhe vonimi i plakjes.

Haxhi, po ashtu, është një nga detyrimet e Islamit, i cili është vizita rituale në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut (Qabe) në Mekë.

Haxhi është sezon vjetor, por është detyrë për njeriun vetëm një herë në jetë, nëse ka mundësi.

Në Haxh mblidhen Muslimanët nga të gjitha anët e botës në një vend të vetëm, në një kohë të vetme, me një veshje të përbashkët, të bardhë.

Në Haxh nuk ka dallim mes të pasurit dhe të varfrit, të bardhit dhe të ziut, arabit dhe joarabit.

Prandaj, themi se haxhi është një sezon madhështor dhe një tubim madhështor i Muslimanëve, përmes të cilit arrihen dashuria, njohja ndërmjet njerëzve dhe barazia.

14. Cilat janë veçoritë e sistemit ekonomik në Islam?

Përgjigje:

Sistemi ekonomik në Islam paraqet një mes ndërmjet sistemit socialist dhe sistemit kapitalist.

Ai i lejon individit të drejtën e pronësisë private dhe nuk e ndalon zotërimin e pasurisë, siç ndodh në sistemin socialist.

Gjithashtu, Islami e nxit njeriun ta fitojë pasurinë përmes shitblerjes dhe rrugëve të ligjshme e të lejuara, që bazohen në drejtësi dhe ndershmëri. Megjithatë, kjo nuk do të thotë liri e pakufizuar që lejon padrejtësinë ndaj të tjerëve ose përvetësimin e pasurisë së tyre pa të drejtë, siç veprohet në sistemin kapitalist.

Një nga treguesit e suksesit të sistemit ekonomik islam është se, kur ndodhi kriza e njohur financiare botërore e vitit 2008, gjatë së cilës falimentuan shumë banka, Vatikani dhe disa ekspertë të famshëm financiarë filluan të kërkojnë zbatimin e sistemit ekonomik islam.

15. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj gruas?

Përgjigje:

Islami e ka nderuar gruan dhe i ka dhënë asaj të drejta të plota.

Kjo nuk gjendej në qytetërimet e lashta. Në qytetërimin grek, gruaja ishte e privuar nga liria dhe pozita shoqërore. Ajo shihej me përçmim dhe si e pavlerë. Lindja e vajzës ishte e urryer, ishte arsye për pikëllim dhe gratë përdoreshin më shpesh për kënaqësi seksuale dhe prostitucion.

Në qytetërimin romak, pozita dhe dinjiteti i gruas u ulën edhe më shumë sesa thjesht në lakuriqësi dhe prostitucion.

Në Hinduizëm, në vendet e Indisë, konsiderohej se kur vdiste burri, gruaja nuk kishte të drejtë të vazhdonte jetën, por në fakt duhej të vdiste po atë ditë dhe të digjej së bashku me trupin e tij, ndonjëherë edhe para djegies së kufomës së tij.

Te disa grupe hebraike (jehude) gruaja trajtohej me përbuzje dhe përçmim. Vajza konsiderohej si shërbëtore, babai kishte të drejtë ta shiste gjersa ishte akoma e mitur dhe ajo nuk kishte të drejtë trashëgimie. Madje vetë ajo konsiderohej pjesë e trashëgimisë së të vdekurit.

Në kohën e mbretit anglez Henri VIII, Parlamenti anglez nxori një vendim që ua ndalonte grave leximin e Dhiatës së Re, sepse konsideroheshin të papastra. Po ashtu, deri në vitin 1805, ligji anglez e lejonte burrin të shiste gruan e tij, madje ishte caktuar edhe çmimi i saj: nëntë pence (gjysmë shilingu).

Në kohët e sotme, gruaja shfrytëzohet për reklama mediatike, i cenohet nderi teksa kompanitë reklamuese i paraqesin me veshje të pahijshme përskaj veturave e makinerive të rënda, me qëllim të promovimit të produkteve dhe tërheqjes së blerësve.

Para zbritjes së Kur'anit, arabët e nënçmonin dhe i bënin padrejtësi gruas. Ata ia mohonin të drejtën e trashëgimisë dhe, në shumë raste, i varrosnin vajzat të gjalla menjëherë pas lindjes.

Me shpalljen e Kur'anit dhe hyrjen e njerëzve në Islam, këto zakone u zhdukën, sepse Islami është fe e drejtësisë dhe e mëshirës.

Islami e ngriti pozitën e gruas dhe i dha asaj nderim.

I Dërguari i Islamit, Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem,* ishte shkaktar kryesor i dhënies së të drejtave të plota gruas. Ai i porosiste vazhdimisht shokët e tij që të silleshin mirë me gratë dhe t'u kushtonin vëmendje atyre. Ai thoshte:

استوصوا بِالنِّسَاءِ خَيْرًا

"Kështillojeni njëri-tjetrin që të silleni mirë me gratë." [Transmeton el-Bukharij (3331), Muslim (1468)]

Kështu, në dritën e mësimeve islame, gruaja u bë e nderuar dhe e respektuar. Ajo është edukatore e brezave dhe përmirësimi i shoqërisë është i lidhur me përmirësimin e saj, ndërsa prishja dhe shthurja e saj ndikon në prishjen dhe

shthurjen e shoqërisë. Kjo, për shkak të rolit të madh që ka në shtëpinë e saj, i cili është edukimi i fëmijëve, prej të cilëve formohet shoqëria.

Në Islam, gruaja është e nderuar dhe e respektuar, qoftë si nënë, motër, bashkëshorte apo bijë.

Madje, nga nderimi që Islami i ka bërë gruas, është caktuar një Sure e plotë në Kuran me emrin Sureja *En-Nisa* [Gratë], e cila i jep rëndësi gruas, dhe përmban shumë dispozita që lidhen me të drejtat dhe marrëdhëniet e saj me bashkëshortin dhe fëmijët.

Ky është argument për kujdesin dhe rëndësinë që Islami i kushton gruas.

16. A i ka bërë padrejtësi Islami gruas duke ia bërë detyrim *hixhabin* (mbulesën)?

Përgjigje:

Islami e ka bërë hixhabin detyrim për gruan, në shenjë nderimi të saj dhe për mbrojtjen e saj.

Hixhabi është mjet i rëndësishëm për ta mbrojtur gruan nga ngacmimet seksuale dhe nga përdhunimi.

Disa studime tregojnë se zhveshja dhe veshjet e pahijshme e rrisin shkallën e përdhunimeve, ndërsa mbulimi i gruas ndihmon në parandalimin e shqetësimeve dhe ngacmimeve seksuale ndaj saj.

Prandaj, qëllimi i hixhabit në Islam është ruajtja dhe mbrojtja e gruas, e jo nënçmimi apo ulja e pozitës së saj.

Për shembull, nëse kemi një ëmbëlsirë të mbuluar, mizat dhe insektet nuk shkojnë tek ajo, por shkojnë tek ëmbëlsira e pambuluar. Kur e mbulojmë ëmbëlsirën, qëllimi ynë është që ta mbrojmë atë nga mizat dhe insektet.

Nëse kështu ndodh me ëmbëlsirën, po çfarë mund të ndodh me gruan, e cila është si xhevahir i çmuar e i ruajtur, e cila meriton edhe më shumë kujdes dhe mbrojtje?!

17. A është Islami fe e terrorizmit?

Përgjigje:

Islami e ndalon vrasjen e njerëzve të pafajshëm pa të drejtë.

Në Kur'anin Fisnik thuhet se ai që vret një njeri të vetëm pa të drejtë, qoftë Musliman apo jomusliman, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzimin.

Allahu i Lartësuar thotë:

مِنْ أَجْلِ ذَٰلِكَ كَتَبْنَا عَلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنَّهُ مَن قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا ۚ وَلَقَدْ جَاءَتْهُمْ رُسُلُنَا بِالْبَيِّنَاتِ ثُمَّ إِنَّ كَثِيرًا مِّنْهُم بَعْدَ ذَٰلِكَ فِي الْأَرْضِ لَمُسْرِفُونَ

"Për këtë arsye, Ne u shpallëm bijve të Israilit se kushdo që vret një njeri, i cili nuk ka vrarë dikë tjetër dhe as ka bërë krime në tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzimin. E kushdo që shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar të gjithë njerëzimin. Me të vërtetë, të Dërguarit Tanë u sollën atyre argumente të qarta, por shumë prej tyre, edhe pas kësaj, i shkelën kufijtë në tokë." [El-Maideh, 32]

Kjo është një dëshmi e qartë se Islami është fe e drejtësisë, mëshirës dhe dhembshurisë.

Gjithashtu, nëse një jomusliman hyn në një vend Musliman me garanci sigurie, nuk lejohet t'i cenohet jeta, pasuria apo nderi.

Në Islam ka kërcënim të rëndë për atë që vret një jomusliman i cili ka hyrë në vendet Islame me garanci sigurie.

I Dërguari i Islamit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem,* ka thënë:

مَنْ قَتَلَ معاهدا لم يرح رائحة الجنة

"Kush vret një person me të cilin është lidhur marrëveshje, nuk do ta nuhasë aromën e Xhenetit." [Transmeton el-Bukharij, 3166]

Kuptimi është se, nëse një Musliman vret një jomusliman të pafajshëm, i cili gëzon siguri dhe mbrojtje, atëherë dënimi ndaj këtij Muslimani është se nuk do të hyjë në Xhennet, sepse ka kryer një krim shumë të madh.

18. A janë Muslimanët terroristë?

Përgjigje:

Terrorizmi nuk ka fe. Ai mund të kryhet nga Muslimani, i Krishteri apo Hebreu.

Gabimet e disa Muslimanëve që kanë rënë në terrorizëm nuk e përfaqësojnë Islamin, por përfaqësojnë vetëm vetët e tyre të neveritshme. Këta njerëz kanë kundërshtuar mësimet e drejta të Islamit.

Nëse një i Krishterë thotë se Islami është fe e terrorizmit për shkak të grupeve terroriste si ISIS ose Al-Kaida, a do të ishte e pranueshme që të thuhej se Krishterimi është fe e terrorizmit për shkak të Kryqëzatave, Inkuizicionit në Evropë, ose masakrës së tmerrshme ndaj Muslimanëve në Bosnjë-Hercegovinë nga forcat serbe?

Apo ngaqë prej të Krishterëve u formua organizata terroriste Ku Klux Klan (KKK), e cila ishte organizatë raciste në SHBA, dhe përdorte kryqin si simbol fetar, si dhe pretendonte se vepronte në emër të fesë dhe të shërbimit ndaj Mesihut (Jezusit), *alejhis-selam,* ndërkaq vriste, torturonte dhe digjte në kryq njerëz me prejardhje afrikane.

Gjithashtu, a pranojnë të Krishterët të thuhet se Krishterimi është fe e terrorizmit, për shkak se një i Krishterë fanatik, në një prej rrugëve të Londrës përplasi qëllimisht me makinën e tij besimtarët muslimanë gjersa po dilnin nga xhamia, në qershor të vitit 2017?!

Ndërkaq, njësia e Policisë për Anti-Terrorizëm e konsideroi këtë incident përplasjeje me makinë si akt terrorist.

Prandaj, arrijmë në përfundimin se terrorizmi nuk ka fe dhe se terroristët nuk përfaqësojnë fenë të cilës i atribuohen, por përfaqësojnë vetëm vetveten.

Sa i përket thënies se "Muslimanët janë terroristë" ose "Islami është fe e terrorizmit" ajo vjen për shkak të kryerjes së veprave terroriste nga disa injorantë Muslimanë. Më pas, këto vepra u shfrytëzuan në mënyrë të keqe e të ligë nga ana e mediave, duke i përfshirë të gjithë Muslimanët, duke ia atribuuar ato Islamit me synimin për ta shtrembëruar imazhin e tij dhe për t'i larguar njerëzit prej tij. Ndërkaq, Islami është i pafajshëm nga këto vepra të këqija dhe kriminale.

Sikur njeriu të hulumtonte për të njohur të vërtetën e Islamit, do ta kuptonte se Islami është fe e mëshirës, fe e drejtësisë dhe fe e paqes, e cila i refuzon të gjitha format e dhunës dhe terrorizmit, viktimat më të shumta të të cilit kanë qenë vetë Muslimanët.

19. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj dhunës?

Përgjigje:

Islami erdhi me refuzim për të gjitha format e dhunës dhe me paralajmërim kundër saj, si dhe erdhi me sqarime për pasojat e këqija të dhunës.

Nga ana tjetër, Islami erdhi duke nxitur drejt butësisë, drejt përvetësimit dhe zbatimin të saj.

Për këtë arsye, i Dërguari i Islamit, Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem,* ka treguar se Allahu i Lartësuar është i Butë dhe e do butësinë. Ashtu edhe i Dërguari i Islamit, Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem,* i inkurajoi njerëzit për butësi ndaj të tjerëve.

Shembull i kësaj është butësia ndaj gruas dhe ndalimi i dhunës ndaj saj. Një nga fjalët e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem,* është:

رفقاً بالقوارير

"Sillu butë me enët prej qelqi." [Transmeton el-Bukharij (6209), Muslim (2323)]

Me këtë shprehje, ai i krahasoi gratë me qelqin, duke treguar se ato duhen trajtuar me kujdes dhe butësi të madhe, që të mos thyhen e të mos pësojnë plasaritje.

Prandaj, dhuna ndaj gruas bie ndesh me mësimet e Islamit, i cili ruan dinjitetin dhe të drejtat e saj dhe kërkon që ajo të jetojë me nderim e respekt, qoftë si nënë, motër, bashkëshorte dhe bijë.

Po kështu, Islami ka nxitur butësinë ndaj fëmijëve. I Dërguari i Islamit, Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem,* sillej me dashuri me ta, luante me ta, u ledhatonte kokën dhe, kur kalonte pranë tyre, ndalonte për t'i përshëndetur me selam.

Ai, gjithashtu, i nxiti njerëzit të tregonin mëshirë ndaj fëmijëve dhe i porositi:

ليس منا من لم يرحم صغيرنا

"Nuk është prej nesh ai që nuk tregon mëshirë ndaj të vegjëlve tanë." [Sahihul-xhami', 5445]

Gjithashtu, Islami ka nxitur për butësi dhe mirësi edhe ndaj kafshëve, shumë shekuj përpara se të krijoheshin shoqatat për mbrojtjen e kafshëve.

Dhunën ndaj kafshëve, si torturimin apo lënien e tyre pa ushqim, Islami e ka ndaluar.

Një shembull të kësaj na e ka treguar Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem,* lidhur me një grua, e cila u fut në Zjarr (Xhehennem), sepse e kishte mbyllur një mace derisa ajo ngordhi; duke mos e ushqyer dhe duke mos i dhënë ujë, dhe as duke mos e lënë të lirë që të ushqehej nga krijesat e tokës.

Po ashtu, Islami ka ndaluar metodat e këqija dhe mizore të therjes së kafshëve, të cilat lejohen për ushqim, siç janë përdorimi i elektroshokut për mbytjen e tyre, shkulja e pendëve të pulave dhe shpendëve gjersa janë gjallë, apo zhytja e tyre në ujë shumë të nxehtë gjersa janë gjallë.

Përkundrazi, Islami ka vendosur udhëzime të veçanta që therja e kafshëve të cilat lejohen për ushqim të bëhet në mënyrë sa më të lehtë dhe sa më pak të dhimbshme për kafshën.

20. Cili është qëndrimi i Islamit ndaj diskriminimit racor?

Përgjigje:

Para Islamit, njerëzit ishin të përçarë, armiqësorë ndaj njëri-tjetrit dhe fanatikë, ku secili mburrej me racën, ngjyrën ose fisin e tij. Madje, ky fanatizëm racor ishte një ndër shkaqet e luftërave dhe përleshjeve mes njerëzve.

Kur erdhi Islami dhe njerëzit e përqafuan atë, këto forma të diskriminimit dhe fanatizmit u zhdukën. Ata u bënë vëllezër, duheshin mes vete dhe bashkëpunonin me njëri-tjetrin, aq sa nuk kishte më dallim mes arabit dhe joarabit, të bardhit dhe të ziut, të pasurit dhe të varfrit. I vetmi kriter me të cilin dikush konsiderohej se kishte epërsi ndaj tjetrit ishte devotshmëria.

Allahu i Lartësuar thotë në Kur'anin Fisnik lidhur me këtë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُم مِّن ذَكَرٍ وَأُنثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا ۚ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِندَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ

"O njerëz! Ne ju kemi krijuar prej një mashkulli dhe një femre dhe ju kemi bërë popuj e fise që të njiheni e bashkëveproni me njëri-tjetrin. Vërtet, më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që është më i devotshëm. Me të vërtetë, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Mirinformuar." [El-Huxhurat, 13]

Profeti Muhammed, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem,* e luftoi me forcë dhe vendosmëri fanatizmin racor. Një nga fjalët e tij lidhur me këtë është:

لا فضلَ لعربيٍّ على عجميٍّ، ولا لعجميٍّ على عربيٍّ، ولا لأبيضَ على أسودَ ، ولا لأسودَ على أبيضَ :إلَّا بالتَّقوَى، النَّاسُ من آدمَ، وآدمُ من ترابٍ

"Arabi nuk ka përparësi ndaj joarabit, as joarabi ndaj arabit; as i bardhi ndaj të ziut, e as i ziu ndaj të bardhit, përveçse me devotshmëri. Të gjithë njerëzit janë prej Ademit, ndërsa Ademi është krijuar prej dheut." [Transmeton Ahmed, 23489]

21. Si mund ta përqafoj fenë Islame?

Përgjigje:

Një nga bukuritë e Islamit është se marrëdhënia ndërmjet robit dhe Zotit të tij nuk ka ndërmjetës. Po ashtu, një nga bukuritë e tij është se hyrja në Islam nuk bëhet me detyrim, por pas njohjes dhe bindjes.

Kur dikush dëshiron të hyjë në Islam, nuk ka nevojë për procedura të ndërlikuara apo për miratim nga persona të caktuar. Përkundrazi, hyrja në Islam është e lehtë dhe e thjeshtë. Këtë mund ta bëjë kushdo, qoftë edhe nëse ndodhet në shkretëtirë apo ndodhet i mbyllur në një dhomë.

Hyrja në Islam bëhet duke shqiptuar Dy Dëshmitë *(shehadetin)*, duke ditur kuptimin e tyre, me sinqeritet, bindje të plotë dhe duke vepruar sipas asaj që kërkojnë ato.

Forma e shqiptimit është:

Esh'hedu en la ilahe il-lAllah ue esh'hedu enne Muhammeden Resulull-Llah

"Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është i Dërguari i Allahut."

Kuptimi i fjalës: "Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut", do të thotë: Pranoj dhe pohoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut.

Ndërsa fjala: "Dëshmoj se Muhammedi është i Dërguari i Allahut", do të thotë:

Pranoj dhe pohoj se Muhammedi është i Dërguari i Allahut për mbarë njerëzimin dhe se ai është vula, i fundit i Profetëve dhe i të Dërguarve.

Kur një person i shqipton këto dy dëshmi me besim të sinqertë, ai bëhet Musliman.

Pas kësaj, ai duhet t'i zbatojë shtyllat e tjera të Islamit, si namazin, zekatin, agjërimin e Ramazanit dhe haxhin, si dhe të mësojë mënyrën e kryerjes së tyre përmes qendrave islame të besueshme dhe librave autentikë islam.

KUSH NA KA KRIJUAR
PËRSE JEMI KRIJUAR
RRUGA PËR TA ADHURUAR KRIJUESIN
JEZUSI
A ËSHTË JEZUSI I ADHURUAR ME TË DREJTË
A ËSHTË JEZUSI BIR I ALLAHUT
MERJEMEJA
PROFETËT DHE TË DËRGUARIT
DITA E GJYKIMIT
PESË DOMOSDOSHMËRITË
ISLAMI DHE LUMTURIA E NJERËZVE
PASTËRTIA PERSONALE DHE PUBLIKE
ADHURIMET DHE DOBITË
EKONOMIA ISLAME
GRUAJA NË ISLAM
A ËSHTË HIXHABI PADREJTËSI
ISLAMI DHE TERRORIZMI
QËNDRIMI NDAJ DHUNËS
DISKRIMINIMI RACOR
SI TA PËRQAFOJ FENË ISLAME?